

## Prof. ass. Dr. Dardan Koçinaj -Kardiolog

Profesioni: Internist- Kardiolog

### Biografia:

Prof. ass. Dr. Dardan Koçinaj, ka diplomuar pranë Fakultetit të Mjekësisë- Mjekësi e përgjithshme, të Universitetit të Prishtinës në vitin 1998. Specializimin nga Mjekësia Interne e përfundoi me sukses në fund të vitit 2003 në Prishtinë. Pas qendrimit një vjeçar (2004/ 2005) në Itali është specializuar në Kardiologji Adulte.

Titullin Magjister i Shkencës e ka fituar në Universitetin e Prishtinës, kurse në Universitetin e Zagrebit në vitin 2012 ka fituar titullin e Doktor Shkencë.

Punon në Klinikën e Kardiologjisë në QKUK dhe ligjeron në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Gjakovës.

Me pjesëmarrje aktive në takime profesionale/ shkencore, brenda dhe jashtë Kosovës, ka prezentuar të dhënat nga projekte kërkimore është kyçur. Poashtu ka publikuar disa punime në revista me recension ndërkombëtar.